

V E N D I M

Nr.32, datë 25.1.1999

PËR DHËNIEN NË ENFITEOZË TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇELIKUT, ELBASAN

Në zbatim të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.8333, datë 23.4.1998 “Për një ndryshim në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dhënie në enfiteozë të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çelikeve, Elbasan shoqërisë “Kurum International” sh.p.k., me qendër në Tiranë, për një periudhë kohe prej 20 vjetësh, sipas kushteve të përgjithshme të kontratës tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Punonjësit, që dalin të papunë nga lidhja e kësaj kontrate, të paguhen për një periudhë kohe prej dy vjetësh nga të ardhurat, që përfitohen nga kjo kontratë.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e procedurave të privatizimit apo të likuidimit të kësaj ndërmarrjeje në rast të mosrealizimit të kësaj kontrate.
4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko